

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7139  
E martë, 12 mars 2024  
Çmimi 0.50

## Suedia nis epokën e re në NATO



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AFËR VENDKALIMEVE KUFITARE SERBIA HAP DEGË DHE BANKOMATE PËR SERBËT E KOSOVËS



Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka njoftuar se ky veprim është bërë me qëllim që serbëve nga Kosova t'u lehtësohet tërheqja

e pagesave nga buxheti i Serbisë të cilat i marrin në dinarë. Ky veprim vjen si reagim pasi Banka Qendrore e Kosovës (BQK) e futi në

fuqi një rregullore më 1 shkurt, e cila përcakton që euroja të jetë valuta e vetme për transaksionet e pagesave në Kosovë

## PUSHTETI DHE OPOZITA KUJTOJNË DEMONSTRATAT E '81-SHIT, THONË SE NDRYSHUAN RRJEDHËN E HISTORISË SË KOSOVËS



## KUSHTE JO TË LEHTA PËR BALLKANIN PËR T'I SIGURUAR PARATË NGA BE-ja

### AKTUALE



## ESCOBARI VIZITON KOSOVËN KËTË JAVË PËR TË DISKUTUAR PËR DIALOGUN DHE DINARIN

## RAMAZANI NË GAZË NIS MES KRIZËS SË PËRKEQËSUAR TË URISË

## DIGJET FABRIKA E PLASTIKËS NË QENDRËN E BIZNESIT NË DRENAS

### EKONOMI



## AUDITORJA E PËRGJITHSHME: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË INSTITUCIONET PUBLIKE, THELBËSORE PËR FUNKSIONIMIN E NJË SHOQËRIE DEMOKRATIKE

## DEPUTETËT TË ENJTEN DEBATOJNË PËR KONTRATAT NJËBURIMORE, OPOZITA I QUAN BURIM KORRUPTIONI DHE KËRKON HETIM

### SPORT



## GJYQTARI GRAMOS SHALA I KËRKON FALJE PUBLIKE GJILANIT

**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Orbani thotë se Trumpi synon ta ndërpresë mbështetjen financiare për Ukrainën

**BUDAPESTI, 11 MARS** - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbani, tha, pas një takimi privat me Donald Trumpin në Shtetet e Bashkuara, se ish-presidenti amerikan ka "plane goxha të hollësishme" për mënyrën se si t'i japë fund luftës së Ruisë në Ukrainë dhe se ai nuk do t'i japë Kievit fonde të tjera për ta shpejtuar përfundimin e konfliktit. Duke folur në një intervistë pasi u kthye në Hungari për televizionin shtetëror M1 më 10 mars, Orbani se "është shumë e qartë se Ukraina e vetme nuk mund të qëndrojë në këmbët e veta".

Qeveria e Orbanit nuk ka pranuar t'i dërgojë armë Kievit derisa i ka ruajtur marrëdhëniet me Moskën.

Lideri hungarez e kreu vizitën në ShBA në një kohë kur një paketë prej 60 miliardë dollarësh është duke u bllokuar nga republikanët

në Dhomën e Përfaqësuesve në ShBA, të cilët po ngulin këmbë që masat për sigurinë kufitare të futen në këtë paketë, në këmbim të mbështetjes së tyre për dërgimin e parave në Kiev.

Presidenti amerikan Joe Biden, një demokrat i cili pritet të jetë kandidat i partisë për zgjedhjet presidenciale në nëntor, e ka mbështetur këtë paketim, por Trumpi e ka kritikuar atë. "Ai nuk do ta derdhë asnjë cent në luftën Ukrainë - Rusi dhe kështu lufta do të përfundojë", tha Orbani në intervistë duke iu referuar Trumpit, i cili pothuajse është bërë kandidat i Partisë Republikane për zgjedhjet e nëntorit. "Nëse amerikanët nuk japin para dhe armë, e as evropianët, atëherë kjo luftë do të marrë fund. Dhe nëse amerikanët nuk japin para, evropianët nuk janë në gjendje ta financojnë këtë



luftë vetëm, dhe kështu kjo luftë do të merrte fund", shtoi ai. Orbani është veçuar në Bashkim Evropian nga shumica e liderëve të bllokut duke i ruajtur marrëdhëniet me liderët autokratikë, siç është presidenti i Ruisë, Vladimir Putin. Orbani udhëtoi drejt Shteteve të Bashkuara javën e kaluar, ku foli

në Fondacionin Konservator të Trashëgimisë dhe më pas u takua me Trumpin në resortin e tij luksoz Mar-a-Lago në Florida, ndërsa nuk pati asnjë takim në Shtëpinë e Bardhë gjatë këtij udhëtimit.

Nga fushata e Trumpit thanë në një komunikatë më 8 mars se gjatë takimit ata biseduan "për një

sërë çështjes në lidhje me Hungarinë dhe Shtetet e Bashkuara, përfshirë edhe rëndësinë parësore të kufijve të fuqishëm dhe të sigurt për ta mbrojtur sovranitetin e secilit komb".

Në komunikatë nuk u përmend Ukraina apo ndonjë temë tjetër. Orbani tha se paqja në Ukrainë duhet patjetër të arrihet së pari përmes një armëpushimi dhe pastaj përmes një marrëveshjeje për paqe, të cilën Trumpi "i ka mjetet" për ta arritur. Ai nuk dha hollësi të tjera.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha më 11 mars se Kremlini është i vetëdijshëm për komentet e Orbanit, por nuk deshë të komentojë. "Ne e kemi parë atë, por nuk kemi çfarë të themi, meqë nuk ka hollësi dhe është e paqartë se çfarë plani mund të jetë ky", tha Peskov.

## Ramazani në Gazë nis mes krizës së përkeqësuar të urisë

Palestinezët e filluan të hënën agjërimin e Ramazanit, muajit të shenjtë të myslimanëve, i cili i gjeti në një kohë kur bisedimet për një armëpushim kanë ngecur dhe kriza e urisë është keqësuar në Rripin e Gazës.

Luftës tashmë pesëmuajore në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA dhe BE - nuk po i shihet fundi.

Palestinezët e falën namazin jashtë ndërtesave të rrënuara të dielën në mbrëmje.

Ata i dekoruan tendat e tyre të stërbushura, ndërsa në një video të publikuar nga një shkollë e OKB-së e shndërruar në strehimore, fëmijët shihen duke vallëzuar me muzikën e një burri që këndonte me altoparant.

Por, kishte shumë pak për të festuar pas pesë muajsh luftimesh që ua kanë marrë jetën mbi 30 000 palestinezëve dhe e kanë rrënuar shumicën e Gazës. Familjet zakonisht e prishin agjërimin me



iftar festiv, por madje edhe në vendet ku ka ushqim, shumica është ushqim i konservuar dhe çmimet janë tejet të larta për shumicën. "Nuk mund ta shohësh askënd të gëzuar", tha Sabah al-Hendi, i cili po blinte ushqim të dielën në qytetin Rafah. "Çdo familje është e trishtuar. Çdo familje e ka një martir", shtoi ai. Shtetet e Bashkuara, Egjipti dhe Katari kishin shpresuar se do ta

ndërmjetësonin një armëpushim para muajit të agjërimin nga agimi deri në muzg, në të cilin do të përfshihej edhe lirimi i dhjetëra pengjeve izraelite në këmbim të të burgosurve palestinezë, si dhe futja e sasive të mëdha të ndihmave humanitare, por bisedimet ngecën javën e kaluar.

Hamasit po kërkon garanci se një marrëveshje e tillë do të çojë drejt

përfundimit të luftës, derisa kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, është zotuar se do ta vazhdojë ofensivën deri në "fitore të plotë" kundër grupit radikal dhe deri në lirimin e të gjitha pengjeve të mbetura.

Lufta nisi kur pjesëtarët e Hamasit u futën vullshëm në jug të Izraelit më 7 tetor, ku i vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe i morën mbi 250 pengje. Besohet se Hamas është duke i mbajtur ende rreth 100 pengje.

Lufta i ka detyruar 80 për qind të popullsisë prej 2.3 milionësh të Gazës të ikin nga shtëpitë e tyre dhe i ka shtyrë qindra mijëra njerëz drejt urisë absolute. Zyrtarët shëndetësorë në Gazë thonë se së paku 20 njerëz, kryesisht fëmijë, kanë vdekur nga kequshqyerja apo dehidrimi në veri të Gazës.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, e ka pranuar në mesazhin e tij vjetor për Ramazanin, se muaji i shenjtë erdhi "në një kohë të

dhimbjes së madhe". "Derisa myslimanët përreth botës mbledhen në ditët dhe javët në vijim për ta prishur agjërimin, vuajtjet e popullit palestinez do të jenë shqetësimi i parë i shumë njerëzve. Ata janë shqetësimi im, po ashtu", tha Bideni. Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera kanë filluar të hedhin ndihma nga ajri në Gazë javët e fundit, por grupet humanitare thonë se përpjekjet e tilla janë të kushtueshme dhe të pamjaftueshme.

Ushtria amerikane, gjithashtu, ka filluar të dërgojë pajisje për ndërtime dhe një ure detare për dërgimin e ndihmave në Gazë, por ndërtimi i saj do të marrë disa javë kohë.

Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë ndihmë vendimtare ushtarake Izraelit dhe e kanë mbrojtur nga thirrjet ndërkombëtare për armëpushim, derisa i kanë bërë thirrje Qeverisë izraelite të bëjë më shumë për ta shmangur dëmtimin e civilëve dhe objekteve humanitare.

## Kina, Rusia dhe Irani po zhvillojnë stërvitje të përbashkëta detare

**PEKIN, 11 MARS** - Marina e Kinës, Ruisë dhe Iranit po zhvillojnë stërvitje të përbashkëta këtë javë në Gjirin e Omanit, tha Pekini të hënën.

Aktivitetet ushtarake, që do të mbahen nga e hëna deri të premten, synojnë "ta ruajnë bashkërisht sigurinë rajonale detare", sipas një deklarate që Ministria e Mbrojtjes e Kinës publikoi në platformën e medieve sociale "WeChat". "Kina do të dërgojë... shkatërruesin me raketa të drejtuar Urumqi, fregatën Linyi me raketa të drejtuar dhe anijen e furnizimit

gjithëpërfshirës Dongpinghu, për të marrë pjesë në stërvitje", shtohet në deklaratë, pa dhënë më shumë detaje.

Stërvitjet në zonë u mbajtën në mars të vitit të kaluar midis këtyre shteteve dhe queshin "Security Bond 2023".

Raundi i stërvitjeve të përbashkëta të këtij viti vjen në kohën e tensioneve në rritje në rajon, teksa lufta në Gazë po vazhdon dhe rebelët Huthi, të mbështetur nga Irani, në Jemen kanë nisur një mori sulmesh ndaj anijeve në Detin e Kuq.

Lufta në Rripin e Gazës nisi pas

sulmeve të Hamasit - i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në jug të Izraelit më 7 tetor, kur ekstremistët palestinezë vranë afër 1 200 persona dhe rrëmbyen afër 250 të tjerë.

Media shtetërore ruse raportoi se një shkeputte anijesh nga flota e Paqësorit të vendit, e udhëhequr nga kryqëzori Varyag, mbërriti në portin iranian të Chah Bahar të hënën, para stërvitjeve. "Pjesa praktike e stërvitjeve do të zhvillohet në ujërat e Gjirit të Omanit në Detin Arabik", raportuan



agjencitë ruse të lajmeve duke cituar Ministrinë e Mbrojtjes. "Qëllimi kryesor i stërvitjeve

është të punohet në sigurinë e aktivitetit ekonomik detar", citohet të ketë thënë ministria.



# Escobari këtë javë viziton Kosovën për të diskutuar për dialogun dhe dinarin

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 MARS - I dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, do ta vizitojë Prishtinën këtë javë për të biseduar me liderët e Qeverisë së Kosovës për dialogun mes saj dhe Serbisë, si dhe për dinarin e ndalur serb në Kosovë, njoftoi Departamenti Amerikan i Shtetit të dielën.

Escobari do t'i vizitojë Belgjikën, Kosovën, Austrinë dhe Malin e Zi nga 10 deri më 18 mars 2024, sipas njoftimit. Ai pritet të jetë në Prishtinë nga e mërkura. "Vizita e tij do ta ritheksojë përkushtimin e shteteve të Bashkuara për vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat e synojnë integrimin euroatlantik dhe një bashkëpunim më të thellë rajonal", tha Departamenti i Shtetit.

Escobari e viziton Kosovën në një kohë kur marrëdhëniet e zyrtarëve amerikanë me Qeverinë e Kosovës duken të tensionuara për shkak të çështjes së dinarit serb, të cilin Banka Qendrore e Kosovës e ndaloi përmes një rregulloreje muajin e kaluar.

Muajin e kaluar Escobari tha se Qeveria e Kosovës nuk po e trajton ShBA-në si partnere për shkak të mosdëgjimit të kërkesës amerikane për çështjen e dinarit serb. "Ne jemi shumë të shqetësuar sepse Qeveria e



Kosovës nuk po na trajton si partnerë. Ata nuk punojnë me ne për stabilitetin rajonal dhe minojnë dialogun, proces për të cilin ShBA-ja është e përkushtuar plotësisht", kishte thënë Escobari më 23 shkurt.

ShBA-ja ka kërkuar shtyrjen e zbatimit të këtij vendimi, duke argumentuar se ai është miratuar pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimet negative të komuniteti serb në Kosovë, që përdor valutën kombëtare të Serbisë. Departamenti i Shtetit tha se i

dërguari amerikan do të takohet edhe me shoqërinë civile dhe komunitetin serb në Kosovë, përveç zyrtarëve qeveritarë. "Ai do të mbajë takime edhe në lidhje me ndikimin e rregullore së re të Bankës Qendrore të Kosovës për pagesat me para të gatshme dhe për të bërë thirrje për ndërmarrjen e hapave për plotësimin e nevojave të qytetarëve të Kosovës pa pengesa", thuhet në njoftim.

Rregullorja e BQK-së, që parasheh vetëm euron valutë me të cilën mund të kryhen

pagesat me para të gatshme, filloi të zbatohet nga 1 shkurti.

Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi u paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë. Rregullorja është kritikuar nga Bashkimi Evropian.

Më 4 mars ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, dhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, i bënë thirrje Kosovës t'i pëmbushë marrëveshjet e arritura në

dialogun me Serbinë nëse dëshiron të anëtarësohet në BE dhe në NATO. "Bashkësia ndërkombëtare do që Kosova të përparojë në rrugën evropiane. Kemi krijuar kushtet për ta arritur këtë. Dhe mënyra e vetme është përmes dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Shpresojmë të shohim përpjekje për të ecur para", tha Hovenieri. Me ndërmjetësimin e BE-së, Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve më 27 shkurt të vitit 2023. Marrëveshja për normalizim, prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

BE-ja ka thënë se marrëveshja, e cila edhe pse nuk është nënshkruar, është detyrim për palët, ende nuk ka nisur të zbatohet.

Ndërkohë, në Belgjikë, Escobari do të takohet me të dërguarin e Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak dhe me zyrtarë evropianë dhe të NATO-s për të biseduar "për përpjekjet për t'i çuar përpara reformat të cilat do të sjellin prosperitet, stabilitet dhe paqe afatgjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor", thuhet në njoftim.

## Digjet fabrika e plastikës në Qendrën e Biznesit në Drenas

DRENAS, 11 MARS - Pas shpërthimit të zjarrit në Fabrikën e Plastikës, në Qendrën e Biznesit Drenasi I, kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se ka aktivizuar Shtabin Emergjent të komunës së Drenasit. "Kjo është katastrofë materiale dhe ekologjike. Kam ftuar për ndihmë edhe kolegët e nivelit lokal, edhe të nivelit qendror, për shuarjen e zjarrit. Falënderoj zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, inspektoratet dhe të gjithë të tjerët që po ndihmojnë për shuarjen e zjarrit. Rreth objektit që po digjet janë në gatishmëri ekipet e zjarrfikësve për të mos lejuar përhapjen e zjarrit në fabrikat e tjera", ka thënë ai.

Lladrovci ka treguar se në përkrahje të zjarrfikësve të

Drenasit kanë arritur edhe njësitë e tjera zjarrfikëse nga Malisheva, Skenderaj, Lipjani dhe Prishtina. "I falënderoj për shpejtësinë e reagimit. Zjarri ka përparuar shumë shpejt sepse ka erë e cila po e ndihmon përhapjen e flakëve dhe lënda e parë që po digjet. Kam shprehur keqardhje për pronarët e fabrikës, për dëmet në fabrikë, pajisjet, objektet, si dhe materialet riprodhuese", është shprehur ai. Lladrovci ka thënë se tymi i madh nga djegia e fabrikës ka arritur në vendbanimet e fshatrave të Drenasit, të Skenderajt e deri të Mitrovicës dhe, sipas tij, po ashtu, është katastrofë ambientale, me ç'rast qytetarët kanë ankesa për ndotjen dhe dëmet që po u shkaktohen.



## Tahiri: Me këtë qeveri Kosova do të mbetet para dyerve të Këshillit të Evropës

PRISHTINË, 11 MARS - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka theksuar se me këtë qeveri Kosova do të

mbetet para dyerve të Këshillit të Evropës. "Me këtë qeveri Kosova do të mbetet para dyerve të Këshillit të Evropës për anëtarësimin e

së cilës i kemi votat që nga koha e qeverisjes sonë. Ambasadori gjerman Rhode shpjegoi hapur se pa u zbatuar vendimi i Gjykatës

Kushtetuese për pronën e Manastirit të Deçanit nuk do të ketë anëtarësim!", ka shkruar Tahiri në "Facebook".





# Kushte jo të lehta për Ballkanin për t'i siguruar paratë nga BE-ja

**PRISHTINË, 11 MARS** - Në dy komisione të Parlamentit Evropian pritet të miratohet raportin për pozicionin e këtij institucioni të BE-së për planin për zhvillim dhe reforma për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - një paketë prej gjithsej 6 miliardë eurosh dedikuar investimeve në këto vende.

Ky votim është pjesë e procedurës së rëndomtë, në mënyrë që vendimi i BE-së të bëhet formal. E për t'u bërë formal, hapi i fundit është që për këtë vendim të propozuar fillimisht nga Komisioni Evropian, të pajtohen në negociata të përbashkëta Këshilli i BE-së, që përfaqëson 27 vendet anëtare dhe Parlamenti Evropian.

Fjala është për një prej paketave më ambicioze që Bashkimi Evropian ka planifikuar për vendet e rajonit të cilat synojnë anëtarësimin në BE.

Kjo paketë është e veçantë, krahas fondeve që tashmë janë në dispozicion në kuadër të programeve të para-anëtarësimit, të njohura me shkurtesën IPA. Me këtë plan, BE-ja synon ta stimulojë rritjen ekonomike në gjashtë vendet e rajonit, paralelisht ta ndihmojë procesin e reformave dhe, në këtë mënyrë, t'u ndihmohet këtyre vendeve që të bëhen gati sa më shpejt për t'u anëtarësuar në BE.

Sipas këtij plani, që fillimisht e ka paraqitur Komisioni Evropian e tash e ka mbështetur edhe Këshilli, për vendet e rajonit do të ndahen dy miliardë euro në formën e parave të gatshme pa kthim, ndërsa 4 miliardë euro do të jenë

në formën e kredive të favorshme. Por, të tria institucionet e BE-së kanë insistuar se vendet e rajonit, për të përfutur nga kjo paketë e asistencës financiare, duhet të përmbushin një varg kriteresh jo dhe aq të lehta.

Në mesin e tyre janë kriteret bazike, të cilat vlejnjë njëloj për të gjitha vendet anëtare. Ato kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, respektimin e parimeve të demokracisë, reformat institucionale dhe ndërmarrjen e hapave të domosdoshëm për të siguruar se mjetet nuk do të keqpërdoren.

Në propozimet e të tria institucioneve të BE-së, që tash duhet të negociohen për t'u miratuar si një vendim i përbashkët, përmendet kushti për kontrollin financiar dhe auditime të pavarura.

Tërhiqet vërejtja se pagesat për projekte të vendeve të rajonit do të jenë të kushtëzuara me kritere strikte që kanë të bëjnë me reforma. Para se të bëhet pagesa, Komisioni Evropian duhet të raportojë se janë përmbushur kushtet dhe vendimin duhet ta miratojë Këshilli. Në rast se konstatohet se ndonjë vend nuk i përmbush më kriteret, atëherë do të suspendohen pagesat.

Pos kriterëve që kanë të bëjnë me reforma dhe sundim të ligjit, do të ketë edhe kritere politike.

Për Kosovën dhe Serbinë "parakusht tjetër" do të jetë "angazhimi konstruktiv në normalizimin e raporteve mes tyre, me qëllim të zbatimit të plotë të obligimeve përkatëse që dalin nga Marrëveshja për rrugën drejt

normalizimit të raporteve dhe Aneksi për implementim dhe "angazhimi për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve".

Për kushtëzimin specifik ndaj Kosovës dhe Serbisë ka pajtim nga të tria institucionet e BE-së, por Parlamenti Evropian kërkon të sqarohen kriteret në bazë të të cilave do të bëhet vlerësimi nëse njëri apo tjetri vend i ka përmbushur kushtet.

Sipas praktikës, kompetencat për të bërë vlerësime për këtë i ka Komisioni Evropian, i cili duhet ta marrë parasysh edhe kontributin e Shërbimit të Veprimt të Jashtëm të BE-së (EEAS).

Diplomatët në Bruksel tërheqin vërejtjen se ky kusht nuk duhet të kuptohet me lehtësi as nga Kosova e as nga Serbia. "Nëse sot do të duhej të vendosej për pagesat për Kosovën dhe Serbinë, vendimi nuk do të ishte pozitiv, sepse asnjëra palë nuk i ka përmbushur obligimet nga marrëveshjet e dialogut dhe për këtë BE-ja ka shprehur edhe keqardhje", ka thënë për Radion Evropa e Lirë një diplomat i BE-së.

Pritet që në negociatat nga 14 marsi deri më 2 prill mes delegacioneve të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, një prej temave ku mund të ketë dallime të jetë përshtatja e vendeve të rajonit me politikën e jashtme të BE-së

Këtu ka dallim në tekstet e përgatitura nga Këshilli dhe ai nga Parlamenti Evropian, ndonëse të dyja përmendin përshtatjen në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Por, Këshilli këtë e

përmend si "pritje", ndërsa Parlamenti si "parakusht".

Në njoftimin e Këshillit të BE-së nga 6 marsi, kur ishte arritur pajtimi i 27 vendeve anëtare, thuhet se "një fokus i forcuar i kushtohet përshtatjes së partnerëve me qëndrimet e BE-së në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë". Por, në atë dokument të miratuar nuk përmendet në mënyrë të prerë si parakusht përshtatja me qëndrimet e politikës së jashtme. Në të thuhet në mënyrë më të përgjithësuar se "përfutuesit duhet të dëshmojnë përkushtim të besueshëm ndaj vlerave evropiane edhe përmes përshtatjes së tyre me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Unionit, përfshirë edhe masat restriktive".

Parlamenti Evropian ka propozuar që përshtatja me qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme të jetë parakusht i qartë dhe të përmendet edhe formalisht se kjo nënkupton edhe mbështetjen e sanksioneve ndaj Rusisë. "Parakusht tjetër duhet të jetë përshtatja me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Unionit, përfshirë edhe miratimin e masave restriktive ndaj Rusisë, sikur edhe me politikën e BE-së për vizat për vendet e treta", thuhet në propozimin e Parlamentit Evropian.

Ky kusht, nëse pranohet kërkesa e Parlamentit Evropian, do të thotë se asnjë vend i cili nuk i ka mbështetur sanksionet e BE-së ndaj Rusisë, për shkak të pushtimit të Ukrainës, nuk mund të marrë pagesa nga ky fond.

Serbia është i vetmi vend i rajonit i cili deri më tash nuk është

përshtatur me qëndrimet e BE-së sa iu përket sanksioneve ndaj Rusisë.

Nga propozimi i Parlamentit Evropian është hequr fjala "përshtatje e plotë", sepse kjo do t'u hapte mundësi vendeve të ndryshme të BE-së apo Komisionit Evropian për interpretim shumë të gjerë të kushtit dhe me këtë do të kishin probleme disa shtete, sidomos Serbia, Bosnjë-Hercegovina, por edhe Kosova.

Bosnjë-Hercegovina për momentin, sikur edhe Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, kanë përshtatje 100 për qind me qëndrimet e BE-së, por në rastin e Bosnjë-Hercegovinës kjo shpesh varet nga fakti se kush në cilin moment është ministër apo kryetar i qeverisë.

Serbia e ka nivelin e përshtatjes diku rreth 60 për qind. Kosova, e cila vetëm se ka aplikuar për anëtarësim në BE, nuk ka nevojë formalisht të përshtatet, por ajo në shumë raste e ka bërë këtë në mënyrë të njëanshme dhe BE-ja e ka mirëpritur. Megjithatë, disa diplomatë kanë tërhequr vërejtjen edhe për Kosovën se nuk ka 100 për qind përshtatje me qëndrimet e BE-së. Si shembull kanë përmendur hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem, që është në kundërshtim me qëndrimet e përbashkëta të Bashkimit Evropian. Gjithsesi, ata tërheqin vërejtjen se të gjitha vendet e rajonit, nëse seriozisht synojnë t'i përdorin mjetet nga plani i rritjes ekonomike, duhet seriozisht dhe shumë shpejt ta nisin përmbushjen e kriterëve. /REL



# Afër vendkalimeve kufitare Serbia hap degë dhe bankomate për serbët e Kosovës

Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka njoftuar se ky veprim është bërë me qëllim që serbëve nga Kosova t'u lehtësohet tërheqja e pagesave nga buxheti i Serbisë të cilat i marrin në dinarë. Ky veprim vjen si reagim pasi Banka Qendrore e Kosovës (BQK) e futi në fuqi një rregullore më 1 shkurt, e cila përcakton që euroja të jetë valuta e vetme për transaksionet e pagesave në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 11 MARS - Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë njoftoi të hënën se Banka e Postës e Serbisë i ka hapur katër degë të improvizuara bankare në afërsi të pikëkalimeve kufitare me Kosovën, në të cilat, sipas saj, serbët e Kosovës mund t'i tërheqin të ardhurat e tyre nga shteti serb. Sipas një njoftimi, Banka e Postës e Serbisë i ka ngritur degët e improvizuara në pjesën serbe të pikëkalimeve kufitare, Jarinjë, Bërnjak, Konçulj dhe Merdarë.

Zyra për Kosovën në Qeverinë e

Serbisë tha se ky veprim është bërë me qëllim që serbëve nga Kosova t'u lehtësohet tërheqja e pagesave nga buxheti i Serbisë të cilat i marrin në dinarë. Kjo veprim vjen pasi Banka Qendrore e Kosovës (BQK) e futi në fuqi një rregullore më 1 shkurt, e cila përcakton që euroja të jetë valuta e vetme për transaksionet e pagesave në Kosovë.

Në bazë të saj, Dogana e Kosovës dy herë gjatë muajit të kaluar

ndaloi hyrjen e dinarëve nga Serbia në Kosovë, me arsyetimin se nuk e ka miratimin e BQK-së. Si pasojë, pjesëtarët e komunitetit serb në komunat në jug të Ibrit nuk kanë mundur t'i tërheqin të ardhurat nga buxheti i Serbisë prej mesit të muajit shkurt, ndërsa në komunat në veri të Kosovës është e mundur të tërheqin një shumë të kufizuar parash në sportelet e Bankës së Kursimeve Postare.

Zyra për Kosovën thekson se tani

klientët e Kursimores së Postës në degët e improvizuara në pjesën serbe të katër pikave kufitare me Kosovën do të mund t'i kryejnë të gjitha veprimet bankare: tërheqje të pagave, pensione, ndihma financiare sociale dhe të ardhura të tjera. Ata, gjithashtu, mund të kryejnë pagesa në llogaritë në dinarë dhe valuta dhe transaksione të tjera bankare.

Sipas njoftimit, çdo objekt është i pajisur me një bankomat të

Kursimores së Postës, ku do të mundësohet tërheqja e mjeteve nga llogaritë e dinarit në çdo kohë. "Në mbështetje të qytetarëve, banka dërgoi dy degë të lëvizshme me rrota që do të jenë në dispozicion në këto lokacione në përputhje me nevojat e qytetarëve", thuhet në njoftim.

Shtohet se "kjo zgjidhje teknike është e karakterit të përkohshëm derisa të vendoset funksionimi normal i transaksionit të pagesës në zonat serbe në Kosovë".

Përveç Kursimores së Postës, dinarët në Kosovë i përdorin edhe zyrtarët postare që punojnë në sistemin serb, si dhe përdoret edhe në tregti në zonat ku jetojnë serbët. Bashkësia ndërkombëtare shprehu shqetësimin se vendimi i BQK-së për ndalimin e dinarit mund të ketë ndikim negativ të serbët e Kosovës dhe se mund t'i rrisë tensionet etnike, prandaj ka kërkuar shtyrjen e zbatimit të rregullores. Megjithatë, Banka Qendrore e Kosovës ka bërë me dije se faza kalimtare e zbatimit të rregullores së saj nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

Çështja e dinarit ishte edhe temë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 27 shkurt në Bruksel, i cili përfundoi pa rezultat konkret dhe i dërguari i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajčak, tha se nevojiten takime shtesë. Për Kosovën, çështja e dinarit është çështje e brendshme teknike, ndërsa Serbia ngul këmbë që kjo çështje të zgjidhet në dialogun e Brukselit.



## Suedia nis epokën e re në NATO

BRUKSEL, 11 MARS - Flamuri i Suedisë, anëtares më të re të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), u ngrit më 11 mars në

selinë e saj në Bruksel. Flamuj të NATO-s po qëndrisen, ndërsa trajnimet ushtarake po shtohen në Suedi, teksa vendi nordik

po nis epokën e re në aleancën perëndimore. Suedia iu bashkua zyrtarisht NATO-s më 7 mars, dy vjet që nga

aplikimi për t'u anëtarësuar në aleancën ushtarake pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.





## Tahiri, akuza qeverisë: Çmimet e artikujve ushqimorë kanë shkuar në qiell, pagat kanë mbetur të njëjta

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 MARS - Shefi i grup parlamentarit i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë të hënën se kjo qeveri ka hyrë në vitin e katërt dhe ende është duke vajtuar dhe nuk jep përgjigje për asnjë temë që rregullon jetën.

Ai ka thënë se Kosova është duke u zbratur. "Të rinjtë dhe të rejtat janë duke kërkuar mundësi për të marrë një vizë pune për ta lëshuar Kosovën. Çmimet e artikujve ushqimorë kanë shkuar në qiell, përderisa pagat kanë mbetur të njëjta. Nuk ka rritje të pagës as në sektorin publik e as të pagës minimale. Si të rrinë të rinjtë dhe të rejtat në Kosovë? Ende flasin për marrëveshjet ndërkombëtare, ende flasin në të majtë për BE-në e në të djathtë për ShBA-në, por problemi nacional në Kosovë është mbijetesia - të lidhet muaji me muaj. Këtë problem qeveria është duke u munduar ta largojë prej agjendës duke u marrë me tema që janë pranuar", ka thënë Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Ai ka parashtruar pyetje për qeverinë Kurti. "Sot pyetjet shtrohen për dialogun, për Asociacionin, kur gjërat po dihen. A është kjo qeveri dhe ky kryeministër që e kanë pranuar marrëveshjen e Brukselit? A është kjo qeveri që e ka pranuar planin

e veprimit në Ohër? A është kjo qeveri që, së bashku me zëvendëskryeministrin, e kanë pranuar edhe një marrëveshje tjetër në Bratislavë? A është kjo qeveri dhe ky kryeministër që po thonë 'nesër e nënshkruajmë Asociacionin dhe marrëveshjet ndërkombëtare?' Problem nuk është Asociacioni, sepse ai është pranuar. Problem është jetesa në Kosovë. Po merremi me tema që nuk janë duke u dhënë kuptim jetës", ka theksuar Tahiri.

Ai ka thënë se çështja e dinarit e ka zhvendosur debatin dhe kritikën ndaj Serbisë për sulmin e 24 shtatorit. "Një temë e cila është brendshme dhe që ishte rregulluar me një rregullore të BQK-së, na është bërë temë ndërkombëtare që flitet në Këshill të Sigurimit. Nuk flet askush për sponsorizimin, organizimin e sulmit në Banjskë më 24 shtator nga Qeveria e Serbisë", ka thënë Tahiri.

Duke folur për zgjedhjet parlamentare, Tahiri ka thënë se në qoftë se nuk mbahen zgjedhjet këtë vit atëherë, sipas tij, mesi i gushtit është koha kur mund të shpallet data e zgjedhjeve. "Pra, janë gjashtë muaj para zgjedhjeve, që nënkupton se zgjedhje kemi ose në janar ose 16 shkurt është dita e fundit, e që Kurti ka dëshirë t'i bie sërish 14 shkurti. Qytetarët duhet të dinë se në zgjedhje të jashtëzakonshme shkojmë përmes dorëheqjes. Pyetja ime



është se a jep Kurti dorëheqje duke i lënë xhipat e zi e të gjitha këto privilegje? Nuk jep dorëheqje, sepse i bie të dorëzohet", është shprehur ai. Tahiri ka thënë se mënyra e dytë për të shkuar në zgjedhje është mocioni i mosbesimit i AAK-së, të cilin nuk e nënshkruan opozita, për t'u votuar me 61 vota. "Mënyra e tretë për të shkuar në zgjedhje është shpërbërja e

parlamentit me dy të tretat e deputetëve. Kurti nuk do të japë dorëheqje sepse është tradhti ndaj 50-përqindëshit, por po kërkon nga deputetët që vetë ta shkëpusin mandatin", ka deklaruar Tahiri.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së ka folur edhe për zgjedhjet në veri. "AAK-ja ka qenë subjekti i vetëm në Kuvend që i ka thënë Kurtit të mos hyjë në ato zgjedhje

për shkak se do të ketë zgjedhje pa pjesëmarrje të qytetarëve serbë dhe do të na krijohet një problem ku do të dalim keq si Kosovë. Megjithatë, këtu bashkëfajtor në këtë temë është edhe bashkësia ndërkombëtare e cila i kërkonin legalitet, por ia kontestonte legjitimitetin. Ndërkaq, peticioni ka krijuar një precedent të keq për komunat e tjera të Kosovës", ka thënë Tahiri.

## Theksohet mungesa e një ligji që rregullon profesionet terapeutike, duke përfshirë logopedinë

PRISHTINË, 11 MARS - Kolegji "Heimerer" ka mbajtur tryezë në kuadër të Muajit të Logopedisë me temën "Korniza ligjore e profesionit të logopedisë dhe bashkëpunimi me profesione të tjera - mungesa e ligjit për rregullimin e profesioneve terapeutike". Kjo temë u trajtua nga ekspertë të fushës, profesorë dhe autoritete shtetërore të vendit. Diskutimet u përqendruan te sfidat që përballon profesioni i logopedisë në mungesën e një ligji të rregulluar dhe protokollit për bashkëpunimin e rregullt me profesionet e tjera.

Një përfshirje aktive në ekipet multidisiplinare dhe qasja e intervenimit të hershëm u shpalosën si prioritete.

Nga të pranishmit u vlerësua si aktivitet i rëndësishëm për t'ua hapur rrugën zhvillimeve të mëtejshme në fushën e logopedisë dhe për ta rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtij profesioni.

Në kuadër të diskutimeve u theksua mungesa e një ligji që rregullon profesionet terapeutike duke përfshirë logopedinë.

Në sistemin arsimor parauniversitar, termi "logoped"



nuk ekziston fare, ky term ekziston vetëm si bashkëpunëtor profesional te ligji për fëmijërinë e hershme, ndërsa në fushën e shëndetësisë logopedia njihet si një profesion i pavarur. Gjithashtu, u theksua mungesa e

protokollit për bashkëpunimin me profesionet e tjera. Diskutimet shtruan nevojën për një protokoll të qartë që rregullon bashkëpunimin në mes të profesioneve terapeutike, duke adresuar konfliktet e mundshme

mes profesioneve të tjera dhe ofrimit të shërbimeve duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë.

Sa i përket mungesës së ligjit për krijimin e ODA-ve për profesionet terapeutike, u

vlerësua rëndësia e krijimit të odave profesionale për profesionet terapeutike, duke krijuar një mjedis të përkrahur dhe të koordinuar për ushtruesit e profesionit.

Gjatë debatit u theksua nevoja për përfshirjen aktive të logopedëve në ekipe të ndryshme multidisiplinare, duke theksuar rolin e tyre të rëndësishëm në kujdesin e shëndetit dhe edukimit.

Në përfundim të tryezës, Izet Sadiku, drejtor i Shëndetësisë në komunën e Prishtinës, paraqiti një projekt që tashmë veçse ka filluar të zbatohet me përfshirjen e profesionistëve terapeutikë, duke përfshirë logopedët dhe ergoterapeutët, në ekipet multidisiplinare të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, për ta zgjeruar më pas edhe në qendrat e mjekësisë familjare të tjera dhe, po ashtu, në komunat e tjera të Kosovës.

Ndërkaq deputeti i Kuvendit të Kosovës, Armend Zemaj, ka premtuar një takim në Kuvend për adresimin e çështjeve të ngritura në këtë tryezë, ku të ftuar do të jenë edhe profesionistët e fushave terapeutike.



# Pushteti dhe opozita kujtojnë demonstratat e '81-shit, thonë se ndryshuan rrjedhën e historisë së Kosovës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 MARS - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar demonstratat e vitit 1981, duke theksuar se guximi i studentëve i dha formë kauzës për Kosovën Republikë e përbushur më 17 shkurt 2008. “43 vjet më parë guximi i studentëve, i manifestuar me demonstrata, bëri që kauza jonë për Kosovën Republikë të

Republikë. “Trashëgimia e demonstratave të vitit 1981 është në funksion të kujtesës së fuqisë transformuese të studentëve për të bërë ndryshime rrënjësore. Guximi, qëndrueshmëria dhe rezistenca e studentëve të atij brezi mbajti në supë luftën për liri dhe sovranitet, duke çuar përfundimisht në realizimin e ëndrrës për Kosovën Republikë, të cilën çdo ditë e më tepër duhet ta ruajmë dhe ta fuqizojmë”, ka

thënë Osmani.

Edhe kryeministri Albin Kurti ka shkruar për 43-vjetorin e demonstratave të vitit 1981. “Këto ditë bëhen 43 vjet prej demonstratave të vitit 1981, të cilat filluan më 11 mars të atij viti. Pas një revolte spontane për kushte më të mira në Mensën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës më 4 mars, një javë më pas u organizua demonstrata e parë masive e një serie të tillash, që në histori kanë hyrë si ‘Demonstratat e ‘81-shit’. Sikur revolta e 4 marsit ashtu edhe demonstrata e 11 marsit u shtypën me dhunë nga policia e Jugosllavisë ku po rritej dominimi i Serbisë. Nga ky reagim u ngjiz një lëvizje e tërë e aktivizmit politik, që duke artikuluar politikisht pakënaqësinë e shqiptarëve të Kosovës ndaj pabarazisë në qasje të shtetit federativ të Jugosllavisë, brenda një muaji, nxori në rrugë për të demonstruar qindra mijëra njerëz të një popullsie të Kosovës asokohe diç më shumë se një milion e gjysmë. Demonstratat e vitit 1981 ishin revoltë gjithëpopullore ndaj një periudhe të gjatë ku shqiptarët në Jugosllavi ishin të nënpërfaqësuar, të diskriminuar, të shtypur, të eksploatuar ekonomikisht, të kufizuar në të drejta kulturore dhe politike. Kështu, Kosova ishte lënë si zona më e pazhvilluar dhe më e prapambetur në Jugosllavi, pors një koloni”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Ai ka thënë se pas demonstratës së 11 marsit u demonstrua edhe më 26 mars, më 1 dhe 2 prill 1981,



si dhe në tubime dhe aktivitete të tjera. “Të gjitha këto u shtypën egërsisht nga policia dhe aparati shtetëror i dhunës, pasuar nga përndjekje, gjyqe politike, burgosje, tortura dhe vrasje. Rreth një e treta e popullsisë së Kosovës u përfshi nëpër procedura ndalimi policor apo gjyqësor dhe marrje në pyetje përgjatë viteve në vijim, teksa mbi tre mijë të burgosur i kaluan mbi 25 mijë vjet në burgje. Kështu, më 1986, Kosova ishte vendi me numrin më të lartë të të burgosurve politikë në Evropë. Menjëherë pas demonstratave të nisura si studentore më 1981 e të shndërruara në popullore, Universitetit të Prishtinës iu ndërrua emri dhe u quajt Universiteti i Kosovës në Prishtinë, deri më 1983 kur iu rikthye emri ‘Universiteti i Prishtinës’”, ka deklaruar Kurti. Ai ka shtuar se demonstratat e vitit 1981 e nxorën parullën popullore “Kosova Republikë”, që

për vite do të vazhdonte të shkruhej edhe si shkurtesë “KR” nëpër mure e rrugë. “Ajo prodhoi një gjeneratë të re të aktivistëve politikë që vetvetiu do ta merrte emrin ‘Brezi ‘81’. Shumë nga aktivistët dhe të burgosurit e demonstratave të vitit 1981 do të angazhoheshin edhe në lëvizjen për çlirimin e Kosovës në dekadën pasuese, që kulmoi me çlirimin e Kosovës nga Serbia në qershor të vitit 1999. Në kujtim të të gjithë të vrarëve nga policia gjatë dhe pas demonstratave të vitit 1981, si dhe në shenjë mirënjohje për përpjekjet e atij brezi për lirinë e Kosovës!”, ka shkruar Kurti.

Për 43-vjetorin e demonstratave të vitit 1981 kanë shkruar edhe liderët e opozitës.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se sot, me nder dhe respekt përkulen para guximit dhe vizionit të atyre studentëve, profesorëve dhe qytetarëve, të cilët qëndruan në papërkulur më 11 mars të vitit 1981, duke ndriçuar rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme për Kosovën.

Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se ishte 11 marsi i vitit 1981 kur studentët e Universitetit të Prishtinës u ngritën kundër shtypjes jugosllave, duke dridhur themelet e regjimit të atëhershëm. “Sot nderojmë ata që i dhanë grushtin shtypjes jugosllave, nderojmë të rënë e atyre ditëve të lavdishme të historisë sonë. Rinia heroike shqiptare, e frymëzuar nga ideali i protestuesve të vitit 1981, do të shkëlqente në istikamet e luftës çlirimtare, e cila e solli fitoren dhe çlirimin”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



marrë formë dhe vazhdojë tutje deri në përbushjen e saj, më 17 shkurt të vitit 2008. ‘Revolta e bukës’, në mensën e Universitetit të Prishtinës ishte, në fakt, revoltë kundrejt një regjimi shtypës, e cila shënoi fillimin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Këto demonstrata ndryshuan rrjedhën e historisë me kauzën e qartë për mbrojtje të dinjitetit, identitetit kombëtar dhe të drejtës për shtet”, ka thënë Osmani.

Ajo ka shtuar se pranvera ‘81-shit është një pikë kthese në historinë e Kosovës, një përpjekje e guximshme kundër shtypjes dhe një pohim i fuqishëm i të drejtës së popullit të Kosovës për liri dhe



## Punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit fizik të UP-së me protestë kërkojnë rritjen e pagave

PRISHTINË, 11 MARS - Punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit fizik të Universitetit të Prishtinës kanë hyrë në javën e katërt të grevës. Të hënën ata kanë organizuar edhe një protestë para Rektoratit duke kërkuar rritjen e pagave. Ata kanë deklaruar se kërkesat e tyre kanë nisur tash e një vit drejt institucioneve përkatese, por deri tash nuk janë shqyrtuar.

Jusuf Azemi, kryetari i

Sindikates së Punëtorëve të Sektorit Privat, ka thënë se me kohë i kanë lajmëruar institucionet për protestë, andaj do të vazhdojnë deri në shqyrtimin e kërkesave të tyre për rritjen e pagave. “Kemi hyrë në javën e katërt të grevës dhe institucioni që e kemi mbrapa nuk po çon peshë dhe dialogu deri më tash është zero. Ju garantoj se ne jemi më të fortë. Ju pa neve nuk mund të punoni dhe ne

pa ju mund të punojmë”, ka thënë Azemi.

Zeqir Krasniqi, punëtor i sigurimit fizik, ka thënë se me 250 euro nuk po arrin ta sigurojë ushqimin për familjen.

Në mbështetje të punëtorëve teknikë ka dalë edhe një pjesë e studentëve të organizatës “Reforma”, të cilët, në fund të javës, me vetiniciativë i kanë pastruar hapësirat e fakulteteve.





## Guvernatori i BQK-së me ambasadorin e Malit të Zi flasin për bashkëpunimin në fushat e interesit të përbashkët

PRISHTINË, 11 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka pritur në takim të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Malit të Zi në vendin tonë, Bernard Çobaj. Guvernatori Ismaili në fillim të takimit e ka njoftuar Çobajn lidhur me aktualitetet në sistemin financiar të vendit, zhvillimet makroekonomike, perspektivën, objektivat dhe planin strategjik të BQK-së. Si pjesë e nismës për avancimin e sistemit financiar,

përfshirë projektin për modernizimin e sistemit të pagesave dhe synimin për anëtarësimin në Zonën e Vetme të Pagesave Euro të Bashkimit Evropian, i njohur si SEPA dhe Sistemin Evropian të Pagesave të Shpejta (TIPS). Në takim u diskutua edhe për sfidat aktuale dhe përparimin drejt digjitalizimit dhe bashkëpunimin potencial në këtë fushë me institucionet malazeze, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Malit të Zi.

Po ashtu është biseduar lidhur me avancimin e kornizës rregullative dhe ligjore, duke përfshirë Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimin e Pagesave dhe ligjet e tjera të cilat kanë si synim përafrimin me direktiva të BE-së. Në fund u konstatua se do të ketë shkëmbime të mëtutjeshme të informacionit me qëllim të bashkëpunimit të mundshëm ndërmjet BQK-së dhe institucioneve malazeze në fushat e interesit të përbashkët.



## Auditorja e Përgjithshme: Transparenca dhe llogaridhënia në institucionet publike, thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 MARS - Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca mori pjesë në konferencën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për lansimin e Studimit për Sistemin e Integritetit Kombëtar në Kosovë, i njohur si NIS. Punimet e konferencës u zhvilluan në tri panele, pjesë e të cilave ishin drejtues të lartë të institucioneve publike.

Në kuadër të panelit të tretë "Roli i institucioneve dhe agjencive të pavarura në garantimin e integritetit institucional", Spanca tha se detyra kryesore e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)



është të vlerësojë nëse fondet publike shpenzohen në mënyrë efikase, efektive, ekonomike dhe në përputhje me kornizën ligjore

dhe prioritetet kombëtare. "Përmes auditimeve vlerësojmë integritetin financiar të institucioneve publike, zbulojmë elemente potenciale të mashtrimit dhe korrupsionit, japim rekomandime për përmirësim dhe e gjithë kjo ndikon në përmirësimin e performancës, transparencës dhe llogaridhënies publike", ka deklaruar Spanca, duke shtuar se përgjatë viteve ZKA-ja ka ndikuar në përmirësimin e raportimit dhe llogaridhënies të institucioneve që janë audituar.

Auditorja e Përgjithshme foli edhe për trajtimin e gjetjeve të auditimit nga institucionet e drejtësisë, duke treguar se ZKA-ja bashkëpunon në

mënyrë të vazhdueshme me institucionet e drejtësisë konform standardeve dhe praktikave më të mira. Ndonëse vetëm për vitin 2022 janë dërguar në prokurori 51 raste për hetim të mëtutjeshëm, sfidë mbetet informata kthyesë nga organet e drejtësisë lidhur me përfundimin e rasteve për të cilat ZKA-ja dërgon informacione.

Spanca ka theksuar se administrata publike në përgjithësi ka përmirësuar llogaridhënien dhe ka rritur nivelin e transparencës, në veçanti në aspektin e menaxhimit të parasë publike, falë investimeve në përmirësimin e sistemeve, si atyre të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.


## Deputetët të enjten debatojnë për kontratat njëburimore, opozita i quan burim korrupsioni dhe kërkon hetim

PRISHTINË, 11 MARS - Kuvendi i Kosovës të enjten do të mbajë seancë të jashtëzakonshme me një pikë të vetme të rendit të ditës: nënshkrimin e kontratave njëburimore.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, u shpreh se kjo seancë e jashtëzakonshme është bërë me kërkesë të deputetes Hykmete Bajrami e përkrahur nga 39 deputetë të tjerë. "Tenderët njëburimor nënkupton dhënien e kryerjes së punëve publike duke mos bërë shpallje publike, por duke ftuar individualisht tri kompani dhe duke vendosur mbi bazën e preferencës së institucionit

tenderues. Konsiderohet shkelje e jashtëzakonshme dhe burim i madh i korrupsionit janë diku mbi 350 tenderë që janë dhënë me procedurën njëburimore", ka thënë Gashi.

Ai shtoi se kjo është një çështje që duhet të diskutohet në Kuvend dhe se kanë propozuar një rezolutë dhe do të shohin mundësinë për krijimin e një komisioni hetimor parlamentar. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se vetëm gjatë vitit 2023 janë lidhur 544 kontrata njëburimore dhe vlera e tyre shkon rreth 116 milionë euro. "Kontratat burimore që



janë kontrata burim i korrupsionit, kontrata të negociuara në tavolinë, që

dëmtojnë buxhetin e Kosovës. Kjo është shqetësuese. Si grup parlamentar i PDK-së kemi

paralajmëruar se do të iniciojmë një komision hetimor parlamentar për t'i hetuar këto kontrata", ka deklaruar Tahiri.

Besnik Tahiri, shef i deputetëve të AAK-së, u shpreh se si grup parlamentar i kanë dhënë mbështetjen për seancën e jashtëzakonshme për kontratat njëburimore. "Një numër kaq i madh i këtyre kontratave duhet t'i nënshtrohet një hetimi serioz dhe të adresohen te Prokuroria e Kosovës. Nuk duhet të jetë askush i heshtur aty ku shihet se ka vendimmarrje të njëanshme, arbitrare dhe korrupsion potencial", ka thënë Besnik Tahiri.

## Bitcoin arrin një rekord të ri, shkon mbi 71 000 dollarë

Prishtinë, 11 mars - Bitcoin (BTC) kaloi 71 000 dollarë për herë të parë ndonjëherë. Kriptovaluta më e madhe tregon se nuk e ka ndër mend të ngadalësohet.

Kriptovaluta është rritur nga një vërshim i parave në fondet e reja

të tregtuara në shkëmbim bitcoin, si dhe nga shpresat që Rezerva Federale së shpejti do t'i ulë normat e interesit.

Vlerësohet se me këtë rritje, bitcoin edhe një herë tregon se "është ende fuqishëm në lojë" pas një "rërmuje" më shumë se

dvyjeçare që vuri në pikëpyetje të ardhmen e të gjithë ekosistemit të kriptovalutave.

Gjatë disa muajve të fundit rritja e bitcoinit është shtyrë nga miratimi i rregullatorëve amerikanë të fondeve të tregtuara në këmbim të lidhura

me aktivin digjital.

Dhe Bitcoin vlerësohet si kryesori për industrinë më të gjerë të kriptove prej 2 trilionë dollarësh, reputacioni i të cilit është goditur nga një sërë ngjarjesh apo titujsh negativë. Bitcoin, i cili përbën më shumë



se gjysmën e të gjitha kriptove në qarkullim, është rritur më shumë se 200 % gjatë 12 muajve të fundit, sipas CoinMarketCap.



# Ramazani filloi, por është njerëzorja e jo besimi im mysliman që më shtyn të qaj për Gazën



Nga: Tahmima ANAM, shkrimtare / The Guardian  
Përkthimi: Telegraf.com

Nuk kam qenë myslimane e devotshme. Nuk agjëroj as nuk falem. Nuk kam qenë kurrë në Mekë për të bërë pelegrinazhin e haxhit. E kam lexuar Kuranin vetëm në anglisht – jo në arabisht, siç bëjnë shumë fëmijë nga Bangladeshi.

Në vend që të mësoja vargjet arabe, u rrita me një dietë të Marksit, Maos dhe teologjisë çlirimtare. Leximi im para gjumit ishin letrat e Nehruit, Nga babai për vajzën, të cilat janë shkruar teksa ishte i burgosur – së bashku me Mahatma Gandhin, gjatë luftës së Indisë për pavarësi. Si shumë burra dhe gra të brezit të tyre, prindërit e mi ishin luftëtarë të lirisë në luftën e pavarësisë së Bangladeshit. Ajo luftë nuk ishte për fenë; në fakt, bëhej fjalë për refuzimin e një identiteti ekskluzivisht fetar. Kur britanikët u larguan nga India duke e lënë të ndarë në dy pjesë në vitin 1947, e krijuan pamundësinë gjeografike të një vendi: Pakistani, i ndarë në mënyrë të pariparueshme midis Lindjes dhe Perëndimit, në dy gjysma njerëzitet të cilave flisnin gjuhë të ndryshme dhe kishin marrëdhënie krejtësisht të

ndryshme me Islamin. Si pakistanezë bengalezë lindorë, në luftën për vetëvendosje prindërit e mi si primare e privilegjuan bengalinë e tyre – identitetin e tyre laik, kulturor, jofetar. Sot, bangladeshasit janë në pjesën më të madhe myslimanë të devotshëm – megjithatë shënojmë festivale kulturore, simbolika dhe ikonografia e të cilave janë rrënjësor në traditën sinkretike në të cilën kanë lindur. Lëvizja për pavarësinë e Bangladeshit dhe lëvizja për çlirimin e Palestinës kanë qenë gjithmonë aleate. Fatet tona u vulosën në mënyrë të ngjashme në vitin 1947, dhe midis daljes së britanikëve dhe fundit të Pakistanit të bashkuar ne ekzistuaam në botë paralele. Organizata për Çlirimin e Palestinës, si Lidhja Avami, bazohej në parimet laike të lirisë kombëtare. Por, në vitin 1971 ne e arritëm lirinë, jo edhe ata. Babai im ma kujtonte këtë fakt kur isha duke u rritur – ishte atëherë që do ta përdorte sa herë që paramendonte se po i merrja si të mirëqena liritë e mia. “Të paktën e ke një vend”, më kujtonte ai. “Kam lindur në Pakistanin Lindor; ti ke lindur në Bangladeshin e çliruar. Imagjino sikur të kishe lindur në Palestinë”.

Fjalët e tij kanë jehonë të thellë për mua në këto 156 ditët e fundit, teksa kemi qenë dëshmitarë të vuajtjeve të paimagjinueshme të popullit të Gazës. Nuk ka asnjë gjuhë që të përfshijë 30 700 vdekjet, pengimin e ndihmave, bombardimet e spitaleve dhe të kampeve të refugjatëve, dhe tani uria e një popullsie të tërë nën rrethim.

Kam qenë mjaft me fat që kam pasur dy modele që demonstuan si përkushtimin fetar ashtu edhe përkushtimin ndaj vlerave laike të barazisë dhe të drejtësisë. E para është nëna ime e cila falet pesë herë në ditë, por që ka festuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas duke marshuar në rrugët e Dakës duke e kërkuar fundin e të gjitha formave të shtypjes ndaj grave. E dyta është nëna e saj e cila ishte e ve e re dhe e cila i rriti fëmijët përkundër vështirësive; besimi i saj ishte burim i madh force në luftën e përjetshme kundër varfërisë dhe problemeve duke qenë nënë vetushqyese.

Për feministet islamike, vizioni kuranor i një komuniteti fetar pa kler, në të cilin adhuruesit kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta, të pandërmjetësuar dhe demokratike me Zotin, është baza për besimin që përfaqëson bazazhinë gjinore. Më pëlqen ky


interpretim, por në përvojën time të ngushtë, feja nuk ka ecur dorë për dore me drejtësinë, dhe kështu e kam shmangur. Rezistoj të identifikohem si shkrimtare myslimane; më vjen keq kur njerëzit i referohen botës myslimane, thujse ekziston një gjë e tillë homogjene. Por, në këtë dimër, teksa banorët e Gazës i janë nënshtruar ndëshkimit kolektiv, ndërsa nënat e Gazës kanë mbajtur qefinët e fëmijëve, pyes veten nëse është koha për ta përqaftuar besimin tim.

Muaji i Ramazanit po fillon. Në shtëpinë time në Daka, prindërit e mi do të ngrihen para agimit, do të hanë një vakt nën ndriçimin e hënës dhe do të agjërojnë deri në perëndim të diellit. Familjet do të mbliidhen për vaktin e iftarit; njerëzit do të thonë lutjet e gjata të teravive – lidhja e tyre me besimin e tyre thellohet përmes përvojës globale, kolektive të lutjes dhe agjërimit.

E, megjithatë, ministri izraelit Amihai Elyahu, i cili më parë ka sugjeruar se Izraeli mund të përdor armë bërthamore në Gazë, ka bërë thirrje për të “fshirë” muajin e Ramazanit. Ky është vetëm një shembull i vogël i çnjerëzimit sistematik të palestinezëve dhe i racizmit e islamofobisë të përhapur antipalestineze. Nivelet e

paprecedentë të dhunës janë përballur, këtu, në Mbretërinë e Bashkuar, me përpjekjet për ta kriminalizuar mospajtimin. Por, kjo nuk është dhe nuk duhet të jetë çështje e solidaritetit fetar. Zemërimi im për atë që po ndodh në Gazë – dhe mënyra se si jemi bërë për ta dëshmuar atë në heshtje dhe pa protestë – nuk vjen nga ndjenja e solidaritetit me myslimanët e tjerë. Nuk duhet të na thyhet zemra për atë që po ndodh në Gazë sepse jemi myslimanë, por thjesht sepse jemi njerëz. Sido që të jetë, ngjarjet e fundit janë përkujtues se angazhimet ndaj identiteteve të caktuara, qofshin ato etnike, fetare apo kombëtare, mund të na e mpijnë njerëzimin dhe të na verbojnë ndaj formave të dhunës institucionalisht të sanksionuar. Si mund ta shpjegojmë ndryshe bombardimin e vazhdueshëm të civilëve ose zinë e afërt të bukës? Do të ishte gabim të barazohej solidariteti fetar me njerëzimin bazik. Siç e ka thënë Kamila Shamsie, kjo është çështja përcaktuese morale e kohës sonë dhe ne duhet, si myslimanë ashtu edhe si jomyslimanë – në Ramazan dhe në çdo kohë të vitit – t'i bashkojmë duart për t'ia dhënë fundin dhunës. /Telegraf i/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Gjyqtari Gramos Shala i kërkon falje publike Gjilanit

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 MARS** - Gjyqtari Gramoz Shala akordoi një penallti në fund të ndeshjes Llapi - Gjilani, e cila edhe e vulosi fatin e ndeshjes 2-1. Pas ndeshjes, trajneri i Gjilanit, Gentian Mezani, e ka quajtur Shalën "mostër" dhe ka kërkuar që atij t'i ndalohej referimi në futbollin e Kosovës. Kritikata nuk kanë munguar as nga shumë analistë dhe njohës të referimit në vend. Pas gjithë këtyre ka reaguar edhe vetë gjyqtari Shala, i cili ka pyetur se kujt po i pengon Gramoz Shala? Ai është ndarë i habitur me analizat nëpër emisionet sportive në televizione se si akuzohet si fajtor për humbjen e investimit milionësh të Federatës së Futbollit për sistemin VAR.

"Duke parë emisionet sportive të opinionistëve e ish-kolegëve se si i analizojnë duke cekur kriteret në studio u atakova shumë për

gabimin tim jo diskutabil, thujse ishte bardhezi, thujse fare s'kishte prekje me dorë. Nuk dua të justifikohem për gabimin, por them me bindje të plotë kujt po i pengon Gramos Shala. Nuk është hera e parë që në studio akuzohem e etiketohem për vendimet e marra që janë të qëllimshme dhe të paditura duke akuzuar se unë jam ai që po e humbi investimin milionësh të FFK-së nga presidenti për VAR-in. Nuk pranoj që karrierën time të dëshmuar prej gjyqtari, që është një profesion jo i lehtë për ta ushtruar dhe vepruar, që e kam ndërtuar me punë e sakrificë dhe dashuri që 22 vjet e nga 2005 në rangun elitare të futbollit të Kosovës, duke gjykuar me shumë se 400 ndeshje dhe shumë ndeshje të rëndësishme me peshë si finalët, barazhet e shumë ndeshje të tjera që kanë përcaktuar, edhe tituj të akuzohem për një gabim që mund t'i kish ndodhur çdo

gjyqtari, e siç ju kanë ndodhur më parë dhe nuk është bërë kaq e madhe si me rastin tim", ka thënë Shala.

Gjyqtari i ka kërkuar falje skuadrës së Gjilanit për gabimin e bërë, duke thënë se kjo është hera e parë që ai i kërkon falje një klubi. "Gabimet e gjyqtarëve ndodhin gjithkund në botë, edhe në ligat më të forta dhe sisteme më të avancuara të teknologjisë. Unë kam analizuar dhe kam marrë vendim për herë të parë në karrierën time që t'i kërkoj falje publike një ekipi S. C. Gjilani dhe tifozëve e dashamirëve të tyre, për një gabim timin, të vetmin rast konkret të ndeshjes. Mosanulimin e penallisë edhe pas rishikimit në VAR, në të kundërtën do të kishim ekipin e KF Llapi që do të ankohet për mosdhënien e penallisë për prekje me dorë", ka shtuar Shala, i cili në fund ka kërkuar nga skuadra e Gjilanit të mos i faturon mosrezultatet te ky rast i vetëm.

## SHKURT

### KB Prishtina shkarkon trajnerin Vuliq

Humbja nga Golden Eagle Ylli ka bërë që drejtuesit e Sigal Prishtinës ta shkarkojnë trajnerin Jaksa Vuliq. "Ju njoftojmë se klubi ka ndarë rrugët me trajnerin Jaksa Vuliq. Trajnerin e falënderojmë për kontributin e dhënë deri më tani", thuhet në postimin e klubit kryeqytetas në faqen në "Facebook".

Trajneri kroat erdhi në krye të Prishtinës gjatë muajit janar dhe gjatë kësaj periudhe nuk i përmbushi pritshmëritë. Arsyeja e largimit të tij ka të bëjë me rezultatet negative, pasi në tri sfidat e fundit kanë pësuar tri humbje. Pas 24 xhirore, Sigal Prishtina është e katërta në tabelë me 14 fitore e 10 humbje.

### Të premtën shorti për gjysmëfinalen e Kupës në futboll

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se tërheqja e shortit për fazën gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll do të bëhet të premtën (më 15 mars), në orën 13:00, në selinë e FFK-së. Pjesëmarrjen në këtë fazë të garave e kanë siguruar Prishtina, Ballkani, Drita dhe Suhareka. Në këtë fazë do të luhet me sistem vajtje-ardhje.

### Stadium me standarde të UEFA-së edhe në Shtime

Edhe qyteti i Shtimes do të bëhet me stadium të ri, modern dhe sipas standardeve të UEFA-së dhe FIFA-së pasi tashmë janë ndarë 2.4 milionë euro për rinovimin e tërësishëm dhe zgjerimin e stadiumit. "Stadiumi i qytetit do të jetë modern dhe sipas standardeve të FIFA-së dhe UEFA-së. Projekti përmban ndërtimin e tribunave të reja për rreth 1200 shikues si dhe pjesët e tjera përcjellëse të stadiumit siç janë zhvështoret, hapësira teknike, hapësira për media etj", thuhet në njoftimin e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Ndryshe, investimet në stadione parashikohet të vazhdojnë për shkak të përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare që do të organizohen në Kosovë në vitin 2030.


## Edge shkëlqen në derbi dhe sërish shpallet MVP

**MITROVICË, 11 MARS** - Trepça po vazhdon me formë të lartë në elitën e basketbollit, derisa në xhiron e 24-t shënoi fitore ndaj Pejës. Basketbollisti që shkëlqeu ishte padyshim Darnell Edge. Basketbollisti amerikan e mbylli ndeshjen me 33 pikë, tri kërcime e katër asistime, duke e pasur indeksin

e ndeshjes 31. Edge realizoi 20 pikë në pjesën e parë dhe ishte i pandalshëm. Ashtu si xhiron e kaluar, ashtu edhe në këtë javë, Edge shpallet MVP i javës. Në një sfidë dramatike, Golden Eagle Ylli shënoi fitore të rëndësishme ndaj Sigal Prishtinës, përballje ku fituesi u përcaktua pas vazhdimeve. Te

therandasit më të mirët ishin Nate Grimes dhe Alonzo Verge Jr. Grimes kishte 23 pikë, 13 kërcime dhe një asistim, kurse Verge Jr kishte 37 pikë, pesë kërcime e tetë asistime. Në një tjetër përballje interesante dhe drame deri në fund, Vëllaznimi shënoi fitore të rëndësishme ndaj Proton Cable Prizrenit, ku

më i miri te kuqezinjët ishte amerikan Jalen Ray, i cili e mbylli ndeshjen me 30 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime. Bashkimi shënoi fitore të pritë kundër Istogut, ku te prizrenasit më i miri ishte Erik Copes, i cili kundër istogasve kishte 21 pikë dhe nëntë kërcime.





## Gripshi pas mori çmimin 'Ylli i javës': Ballkani synon të bëhet sërish kampion

### "Epoka e re"

**SUHAREKË, 11 MARS** - Nazmi Gripshiti i ka takuar çmimi "Ylli i javës" nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall. Vlerësimi i më të mirit për javën e 24-t

është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Avni Shala, Skënder Kapra dhe Sabit Uka. Ky komision vendosi që ky çmimi t'i takojë Gripshit pasi, përveç dy golave, ishte mjaft i përkushtuar edhe në ndërprerjen e aksioneve të

kundërshtarit në mesfushë. Pasi mori këtë çmim futbollisti i FC Ballkanit u shpreh i lumtur për vlerësimin. "Jam i lumtur që kam kontribuar në arritjen e rezultateve pozitive të skuadrës. Zgjedhja si 'Ylli i javës' për mua është një motivim i madh për të ardhmen. Largimi i lojtarëve

kryesorë ka bërë që përgjegjësia më e madhe të jetë tek lojtarët më me përvojë, gjithashtu edhe tek unë. Ballkani synon të bëhet sërish kampion. Ndashjet në kampionat i shoh më sfiduese sesa ato për Kupë", ka thënë Gripshi për faqen zyrtare të FFK-së.



## KOK-u nënshkruan kontrata me 44 bursistë 'Shpresa Olimpikë 2024'

**PRISHTINË, 11 MARS** - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar sot kontratat me 44 bursistë të rinj "Shpresa Olimpikë 2024", të cilët do të mbështeten nga KOK-u me paga mujore në vlerë 150 euro. Në emër të KOK-it, nënshkroi presidenti Ismet Krasniqi, ndërsa nga pala tjetër, sportisti dhe federata. Sportistët i takojnë moshës deri në 21 vjet, ndërsa vijnë nga 20 sporte të ndryshme olimpikë. Bursistët nënshkruan kontratat edhe me sponsorin e artë, BKT Kosova, duke u bërë klientë të tyre. Presidenti Krasniqi ka deklaruar se nga viti në vit KOK po e rrit mbështetjen për sportistët, duke çuar këtë numër nga 35 sa ishte vitin e kaluar, në 44 këtë vit. Në total, numri i bursistëve të KOK-it, përfshirë 22 bursistët olimpikë për Lojërat Olimpikë Paris 2024, pesë për Lojërat Olimpikë Dimërore Milano Cortina 2026, si dhe trajnerët, është 76.



### LISTA E BURSISTËVE "SHPRESA OLIMPIKË 2024":

Dëbora Gjakova, Muhamedin Veseli, Blerina Gashi, Besjana Gashi, Sidorela Dodaj, Laurina Gashi, Mal Agushi, Salidin Rama, Dris Sejdiu, Adriatik Berisha, Egzon Xhoni, Hana Bejiqi, Mal Gashi, Vilëza Zeqiri, Valëza Rama, Fleta Deçani, Lenë Osmani, Shega Hashani, Blend Hajdari, Visar Nuhaj, Amar Maxhuni, Genc Isufi, Emine Jonuzi, Medina Kutleshi, Enis Bytyqi, Olti Bytyqi, Ensar Badallaj, Luan Morina, Denis Bllaca, Elion Agushi, Mal Sahiti, Andi Pupovci, Klara Sefaj, Valmir Gllareva, Anita Krasniqi, Aurora Maliqi, Olsi Mulaj, Arona Krasniqi, Malvina Haziri, Yll Kastrati, Erion Bajrami, Jona Krasniqi, Baton Haxhiu, Kaltrinë Thaçi.

## Lakersat mposhtin Minnesotan, triumfojnë edhe Milwaukee dhe Oklahoma

**LOS ANXHELOS, 11 MARS** - Fitorja e dytë radhazi për Lakersat në NBA, që me ekipet e forta tregon dhembët, duke mposhtur me rezultat 120-109 Minnesotan. James realizoi 29 pikë e Davis 27 pikë e 25 rebounde, një dyshe që bëri diferencën në fushë. Të gjithë titullarët e Lakersave realizuan mbi 13 pikë, ndërkohë që humbja zbret Minnesotan në vendin e tretë në Perëndim. Fiton ekipi i Milwaukee, që mundi me



rezultat 124-117 Clippersat, duke u ngjitur në vendin e dytë në Lindje. Lillard me 35 pikë e Antetokounmpo me 34 pikë ishin liderë në fushë për Bucks. Zhgënjën Miami, që në fushën e tij u mund me rezultat 110-108 nga Washingtoni, ndeshje ku për skuadrën mike u dallua Kuzma, autor i 32 pikëve. Oklahoma

është ngjitur në vendin e parë në Perëndim pas fitores me rezultat 124-93 ndaj Memphisit. Vendimtar ishte stoli i skuadrës së Oklahomës, që realizoi 58 pikë në këtë ndeshje. Fiton edhe Brooklyn, që mundi me shifrat 120-101 Clevelandin, me Cam Thomas protagonist, autor i 29 pikëve.

### REZULTATET

Clippers - Milwaukee	117-124
Sacramento - Houston	104-112
Orlando - Indiana	97-111
Miami - Washington	108-110
Atlanta - New Orleans	103-116
Oklahoma - Memphis	124-93
Cleveland - Brooklyn	101-120
New York - Philadelphia	73-79
Lakers - Minnesota	120-109

## Leclerc: Do ta mposhtim Red Bullin

Charles Leclerc me Ferrarin përfundoi Çmimin e Madh të Arabisë Saudite në vendin e tretë, duke vendosur xhiron më të shpejtë në xhiron e fundit. Piloti monogask tani është i treti në renditjen e pilotëve, tetë pikë pas Sergio Perezit, i cili mbeti i pakapshëm pavarësisht një penalizimi me pesë sekonda. Megjithatë, Ferrari e konfirmoi

veten si forca e dytë në pistë pas Red Bullit për nga distanca. Kjo do të thotë se, në krahasim me vitin 2023, asnjë ekip nuk e ka përmirësuar performancën e tij aq sa "kokëkuqja". Leclerc nënvizoi këtë aspekt duke pranuar se ai kishte një ndihmë të vogël në xhiron e fundit për të vendosur xhiron më të shpejtë. "Mendoj se ne shkuam me një

organizim shumë specifik dhe makina ishte shumë e mirë. Në xhiron e fundit pashë mundësinë për ta vendosur xhiron më të shpejtë duke përdorur DRS pasi isha pas Ricciardos, kështu që shtyva më fort dhe shkoi mirë. Megjithatë, Red Bulli është më i shpejtë", ka thënë Leclerc. "Ka diçka që duhet të kuptojmë se si mund të përfitojmë nga gomat e

buta në kualifikim dhe ato të forta në garë. Ndiheha më afër Red Bullit, por mendoj se ndikoi edhe situata pas makinës së sigurisë. Nuk mund ta drejtojmë gishtin në ndonjë gjë të veçantë, sepse ata janë ende 3-4 të dhjetat më të shpejtë dhe kjo është shumë", ka shtuar Leclerc. "Ne duhet të vazhdojmë të punojmë siç kemi bërë muajt e

fundit. Nga viti i kaluar në këtë vit, skuadra që ka bërë hapin më të madh përpara është e jona dhe kjo falë rezultatit të gjithë punës së bërë. Jemi në një moment pozitiv. Duhet të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim dhe jam i sigurt se kënaqësitë, që janë fitorja dhe mposhtja e Red Bullit, do të vijnë së shpejti", ka pohuar monogasku.

### SHKURT

#### Lecce shkarkon trajnerin, goditi me kokë lojtarin kundërshtar

Roberta D'Aversa nuk është më trajner i Lecces dhe tashmë ka ardhur edhe zyrtarizimi i këtij vendimi. Trajneri ka goditur në përfundim të ndeshjes një lojtar të Veronës me kokë, mbi të gjitha edhe rezultatet negative kanë ndikuar në këtë vendim. "Pas ngjarjeve të ndodhura në fund të ndeshjes mes Lecces dhe Veronës, klubi njofton se ka liruar nga detyra trajnerin Roberto D'Aversa. Faleminderit trajnerit për punën e bërë!", shkruan klubi i Serisë A.

#### Klopp: Kurrë në jetë nuk e kisha parë Cityn duke vuajtur ashtu sikurse ndaj nesh

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka mbetur i kënaqur nga paraqitja e Liverpoolit në ndeshjen ndaj Manchester City (1-1). Strategu gjerman ka thënë se asnjëherë nuk e ka parë Cityn duke vuajtur aq shumë sa në ndeshjen ndaj "Reds"-it. "Kam parë shumë futboll. Unë nuk mendoj se e kam parë ndonjëherë Manchester Cityn të vuajë se si vuajti dhe luftoi në pjesën e dytë. Kam parë kaq shumë shfaqje të bujshme. Të gjithë ishin të jashtëzakonshëm. 10 minutat e para ishin në nxitim dhe nuk ishim me mendjen në fushë. Pjesa e dytë ishte më e mira që kemi luajtur ndonjëherë kundër Cityt", ka deklaruar Klopp.

#### Guardiola flet për përplasjen me De Bruyne

Në barazimin ndërmjet Liverpoolit dhe Manchester Cityt (1-1), një vëmendje të madhe e mori edhe zemërimi i mesfushorit Kevin De Bruyne i cili shprehu hapur pakënaqësinë e tij me trajnerin Pep Guardiola që vendosi ta largonte atë nga fusha. "Jam i lumtur ta shoh atë ashtu. Më pëlqen nëse ai është i mërziur, është mirë. Ai është i lumtur tani. E dija se çfarë na mungonte, na mungonte posedimi i topit. Pasi ai u largua ne e bëmë më mirë. Por, dëgjo. Çfarë mund të them për Kevin, ne kemi nevojë për të dhe ai është i rëndësishëm", ka thënë Guardiola.

#### De Rossi: Ndaj Fiorentinës morëm një pikë të rëndësishme

Pas barazimit 2-2 ndaj Fiorentinës, trajneri i Romës, Daniele De Rossi, e ka cilësuar pikën e marrë shumë të rëndësishme pasi, sipas tij, ndeshja ishte goxha e vështirë. "Nuk më pëlqeu pjesa e parë. Megjithatë, pjesa e dytë shkoi më mirë, por ne nuk patëm shumë gjuajtje në portë. Kundërshtari është shumë i fortë, mos ta harrojmë këtë. Pika e fituar është shumë e rëndësishme, si për moralin, ashtu edhe për renditjen", ka thënë De Rossi. Më tej, duke folur në veçanti për Svilar, trajneri i "verdhekuqve" theksoi se portieri i tyre është fantastik dhe se në këtë përballje ishte vendimtar, duke pritur penallti. "Mile është një djalë fantastik. Ai po punon mirë, i mbështetur nga stafi, trajneri i portierëve dhe Rui. Ai priti një penallti dhe ishte shumë vendimtar", ka deklaruar De Rossi.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Caffe Way” SH.P.K. me seli në Ferizaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811874610 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Caffe Way” D.O.O. Uroshevac, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811874610 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Caffe Way” L.L.C. with headquarters Ferizaj, has come to the decision to quit its business: 811874610 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Avva Group” SH.P.K. me seli në Ferizaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811885584 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Avva Group” D.O.O. Uroshevac, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811885584 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Avva Group” L.L.C. with headquarters Ferizaj, has come to the decision to quit its business: 811885584 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë “Jakova-L”, Sh.P.K

Shoqëria Tregtare “Jakov-L”, SH.P.K., me numër NUI: 810611849, me seli në Gjakovë, në mbështetje të Nenit 147, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-016, për Shoqërinë Tregtare, lëshon këtë:

**NJOFTIM**

Kuvendi i Aksionarëve, në mbledhjen e përgjithshme të datës: 10.03.2024, ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit të përgjithshëm të Shoqërisë “Jakova-L”, SH.P.K., ashtu që kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë do të jetë nga; 1,642,533.70 € me 164,253 aksione me vlerë nominale 10 €, në 2,500 €, me 250 aksione, me vlerë nominale prej 10 € për aksion. Pjesëmarrja e aksionarëve në pronësi nuk do të ndryshojë.

Ky njoftim publikohet me qëllim të njoftimit të kreditorëve të mundshëm të Shoqërisë, në zbatim të Nenit 147 të Ligjit nr. 06/L-016, për Shoqëritë Tregtare.

Gjakovë, 10.03.2024

“Jakova-L”, Sh.P.K.

NUI: 810611849.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Gentian Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Enea Memia nga Tropoja R. Shqipërisë, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 12 të sh.mt. “Nexhmedin Nixha” Instalime Elektrike.

- Nikoll Domgjoni nga Bishtazhin KK Gjakovë. Shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “At Gjergj Fishta” nga kl. 1-5 dhe 6-9 Bishtazhin.

- Gresa Hasanaj nga Deçani shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Yll Morinanga kl. VI-IX në Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992







ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

